VENDIM
Nr. 844, datë 5.11.2026

PËR MIRATIMIN E MASËS SË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE, SI DHE TË PAGESËS PËR KUJDESIN ALTERNATIV PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 31, të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetja financiare për familjen kujdestare dhe për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje, përfshin:

a) mbështetje financiare mujore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje për përmbushjen e nevojave të jetesës së përditshme të fëmijës, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) mbështetje financiare vjetore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje, për përballimin e shpenzimeve të tjera sipas nevojave, në masën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në vit;

c) mbështetje financiare mujore për familjen që ofron kujdes alternativ profesional, të njëjtë dhe të barasvlershme me nivelin e pagës minimale të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Mbështetja financiare mujore e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, jepet një herë në muaj, pavarësisht numrit të fëmijëve në kujdes alternativ, për aq kohë sa familja kujdestare profesionale është e regjistruar si ofruese e shërbimit dhe ka në kujdes alternativ në familje të paktën një fëmijë, sipas vendimit përkatës, me përjashtim të familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, të cilat e përfitojnë pagesën sipas pikës 7, të këtij vendimi.

3. Prindi aplikues i familjes kujdestare profesionale punësohet për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ka vendbanimin e përhershëm dhe lidh kontratë pune me këtë njësi.

4. Marrëdhëniet e punës ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

5. Me marrjen e vendimit gjyqësor për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, përfitimi i mbështetjes financiare, sipas pikës 1, të këtij vendimi, fillon pas lidhjes së kontratës së punës ndërmjet prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Mbështetja financiare ndërpritet me përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

6. Pagesa mujore përfitohet edhe në rastet kur prindi aplikues është i punësuar, i vetëpunësuar ose ushtron një veprimtari tjetër profesionale. Në çdo rast, prindi duhet të sigurojë organizimin e kohës dhe të veprimtarisë në mënyrë të tillë që të mos cenohen në asnjë rast nevojat, siguria, mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijës.

7. Në rastin e familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, përfitimi i pagesës fillon në momentin e lidhjes së kontratës së punës ndërmjet prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale të emergjencës me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe ndërpritet me përfundimin e marrëdhënies së punës/humbjen e statusit të familjes kujdestare profesionale të emergjencës, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë Shërbimin Social Shtetëror, nëpërmjet strukturave rajonale të varësisë, për fillimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit nga familjet kujdestare profesionale dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ, që përfitojnë mbështetje financiare sipas këtij vendimi.

9. Mbështetja financiare e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, indeksohet çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit, nga Shërbimi Social Shtetëror.

10. Fondet për mbështetjen financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje mbulohen nga buxheti i shtetit, të cilat u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama